**Rekomandime**

Ngarkesa në sytha e bimëve gjatë krasiyjes dimërore në vreshta ndikon direkt në rendimentin dhe cilësinë e prodhimit. Në kultivarët e tryezës, pamja tregëtare si tregues kryesor, lidhet direkt me uniformitetin e pjekjes, madhësinë e kokrrave, shfaqien ose jo të fenomenit të milerandimit, cilësi këto të varura kryesisht me ngarkesën në sytha.

Mbështetur në analizën e rezultateve dhe konkluzioneve të dala, për kultivarin "Victoria" rekomandojmë :

Aplikimin e formës së mbajtjes "kordon roaja" bilateral me ngarkesë 12 sytha për bimë, sipas skemës 6 çepa me nga 2 sytha.

Kjo praktikë të ndiqet edhe për gjithë ata kultivarë tryeze me aftësi prodhuese të sythave bazalë. ("Black Magic")etj.

Nuk rekomandohet lënia e sharmendës prodhuese pasi shtesa në rendiment, nuk justifikon pasojat e uljes cilësore të rrushit siç janë ato të uniformitetit në pjekje, zvogëlim të bistakut, çfaqie të theksuar të milerandimit e rjedhimisht edhe në rritjen e vështirësisë së tregtimit.

Realizimi I një cilësie të lartë të rrushit, krahas krasitjes, kërkon shoqërimin me zbatimin e gjithë hallkave të tjera agroteknike.




**H.Fiku Cel. 0692702547**

**E-m: kratifiku@yahoo.com**

**HIPOKRAT FIKU**

# *KRASITJA DIMËRORE NË KULTIVARIN E RRUSHIT "VICTORIA"*

**Fletë-palosje**

**në ndihmë**

**të fermerëve**

**BOTIM I Q.T.T.B.**

**VLORË 2011**